

Procesverbal

Nga Mbledhja IV (e katërt) e rregullt për vitin 2025 e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më datë: 28.04.2025

Rend Dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për seancën e katërt të rregullt; dhe
3. Eventuale.

Arijeta Skeraj: Përshëndetje kryetar, kolegë delegatë, përfaqësues i OSBE-së, të pranishëm të tjerë! Mirë se keni ardhë në Mbledhjen e katërt të rregullt të KPF-së për vitin 2025! Materialin besoj që e keni pranuar të gjithë. I kemi tri pika të rendit të ditës. A do dikush me e marrë fjalën rreth rendit të ditës? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është për këtë rend të ditë? A ka kundër? Abstenim? Me 5 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë rendin e ditës. Atëherë, fillojmë me pikën e parë: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro miratimit të procesverbalit? A ka kundër? Abstenim? Me 5 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë procesverbalin. Vazhdojmë me materialin e Kuvendit: Raporti për realizimin e buxhetit për periudhën janar-mars 2025. A do dikush me e marrë fjalën për këtë pikë? A do dikush me e marrë fjalën rreth rendit të ditës? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 3 vota pro, zero kundër dhe 2 abstenime, edhe kjo pikë kalohet. Vazhdojmë te pika e tretë: Anulimi i Vendimit për financimin e shujtave ditore për nëpunësit e shërbimit civil të Administratës së Komunës së Dragashit 01 Nr. 060. 01-7/25 të datës 28.02.2025. A do dikush me e marrë fjalën për këtë pikë? A do dikush me e marrë fjalën rreth rendit të ditës? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, zero kundër dhe 1 abstenim, e kalojmë edhe këtë pikë. Vazhdojmë me pikën e katërt: Shqyrtimi i kërkesës së OVL të UÇK-së për ndryshimin e datës zyrtare të çlirimit të Komunës së Dragashit nga data 15 në 12 qershor. A do dikush me e marrë fjalën për këtë pikë? A do dikush me e marrë fjalën rreth rendit të ditës? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 5 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e kalojmë edhe pikën e katërt. Atëherë, vazhdojmë me pikën e tretë të KPF-së, pikën eventuale. A do dikush me e marrë fjalën?

Munir Jonuzi: Përshëndetje të gjithëve të pranishëm, po e shfrytëzoj këtë rast për të folur për problemet me të cilat përballen qytetarët, meqenëse nesër ndoshta nuk do të kemi pikën e "të ndryshme". Një nga momentet më të pakëndshme është kur një delegat duhet të flasë për problemet e fshatit prej nga vjen vetë ai delegat. Atëherë diskutimet merren personalisht, në vend që të nisen iniciativa të singerta, ne flasim sikur është në interes personal dhe jo në interes të qytetarëve. Detyra ime si delegat në kuvend është të përmend problemet me të cilat përballen fshati im, Rapça. Së pari, dëshiroj të njoftoj pushtetin ekzekutiv se kompania që ishte e angazhuar në ndërtimin e ujësjellësit qendror në fshat, megjithëse ka kthyer disa pjesë në gjendjen e mëparshme, ka lënë një sasi të konsiderueshme material ndërtimor, rërë, kubëza, mbeturina ndërtimi. Sipas kontratës, ata janë të obliguar të kthejnë gjithçka në gjendjen fillestare, megjithatë këto probleme kanë mbetur. Kryetar, ju lutem që në mënyrë zyrtare ta kontaktoni kompaninë dhe të kërkonit largimin e mbeturinave të mbetura. Së dyti, në emër të këshillit dua të theksoj sjelljen e papërshtatshme të disa zyrtarëve komunalë në propozimin e projekteve kapitale për fshatin Rapçë. Disa nga këta zyrtarë komunalë duan të shfrytëzojnë miqësitë e tyre, fuqinë e tyre të supozuar personale dhe propozojnë projekte që janë në interesin e tyre personal e jo sipas asaj që përcakton këshilli i fshatit. Sipas Udhëzimit Administrativ të vitit 2019, për të gjitha planifikimet nëpër fshatra, komuna duhet të bashkëpunojë me përfaqësuesit e fshatrave. Ju lutem që këtë çështje ta harmonizoni me procedurat ligjore. Kjo është e vërtetë dhe për këtë kemi folur edhe më parë. Së treti, tek ju ka qenë një delegacion nga fshati Rapçë, para një jave, dhe ju ka informuar për problemin e mirëmbajtjes së ndriçimit publik. Edhe unë personalisht kam shkruar për këtë, me një kërkesë përmes organeve komunale. Pa ndonjë zgjidhje konkrete apo rezultat. Ende ajo kompani nuk ka ardhur në fshat për të ndërruar llambat. Në fshat kemi mbi 25 llamba që nuk punojnë. Çështja e katërt, që na dhemb të gjithëve banorëve të fshatit Rapçë, është ujësjellësi i papërfunduar në Rapçën e Poshtme. Kanë kaluar tashmë 5 vite dhe punimet nuk janë përfunduar. Fajtor kryesor është Drejtoria e Urbanizmit, përgjegjësia e drejtorit dhe e disa zyrtarëve që në mënyrë të qartë vendosin sipas linjës politike dhe jo sipas nevojave reale të qytetarëve, duke u përpjekur të shfrytëzojnë fuqinë politike për interesat e grupeve të caktuara politike. Nëse drejtori vepron kështu, ju jeni kryetar i të gjithë qytetarëve, dhe jo i grupeve politike, që të kujdeseni në mënyrë të barabartë për problemet me të cilat përballen qytetarët e Gorës dhe të Opojës. Sot i keni të gjitha mjetet në dispozicion për përfundimin e këtij ujësjellësi: keni mjete, keni fonde nga mallrat dhe shërbimet, nuk bëhet fjalë për ndonjë shumë të madhe. Drejtorët tuaj kanë premtuar, por ka mbetur vetëm tek premtimet. Keni shumë mundësi, çështja është te vullneti për ta përfunduar më në fund këtë ujësjellës. Ju lutem që t'i merrni seriozisht këto probleme që po grumbullohen dhe nuk po zgjidhen.

Edin Kurt: Ashtu siç tha edhe kolegu, më e vështira është kur duhet të flasësh për fshatin tënd. Mua më janë drejtuar banorët e fshatit tim, më saktësisht të një pjese – rrugës së quajtur "Mahalla e Epërme",

të cilët ende nuk janë përfshirë në sistemin e ndriçimit publik. Më herët, para se komuna të merrte përsipër pagesën dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik, kjo rrugë e kishte vetë ndriçimin publik – e paguante dhe e mirëmbante vetë. Tani që komuna ka marrë përgjegjësinë, ata kanë mbetur në të njëjtën gjendje. Ndriçimi është vendosur privatisht. Gjysma e llambave nuk funksionon fare dhe nuk janë të lidhura fare në këtë sistem të ri. Ata i kanë shlyer të gjitha borxhet. I janë drejtuar kolegëve të mi, drejtorit, dhe u është thënë t’i drejtohen mua – ndoshta sepse shumica janë votuesit e mi. Unë po ju drejtohem juve. Kërkoj që ky problem të zgjidhet dhe unë do ta dorëzoj kërkesën zyrtarisht.

Artan Loshaj: Mirëmëngjesi! Përhëndetje për të gjithë! Zonja kryesuese, pikat e rendit të ditës të cilat i kemi në Komitet, e kemi edhe pikën eventuale, ndërsa nesër për seancë nuk është pika eventuale. A është ndonjë gabim, ndonjë lëshim, apo është e qëllimshme? Edhe unë si anëtar i Komitetit – nesër kam me kërkuar, që nesër të jetë pikë e rendit të ditës edhe pika e pestë, pika eventuale. Edhe e dyta është – nesër, kryetar, ma shumë kërkoj, po sot sa për njoftim – qeky manifestimi i 5 majit që po bëhet, një mbledhje e keni mbajtur ju në KKSB, në qoftë se ka mundësi pak me na dhënë sqarime, edhe mandej me u kyç. A do të mbahet, kush është organizatori, a ka bërë kërkesë? Se me një deklaratë të juajën, këtu në faqen zyrtare e lexova, tash mos të hyj me e përsërit, ndërsa në anën tjetër ata e kanë shkruar na mundim me ndërruar datën, po organizimin do ta bojmë. Ata. Ju keni thënë që nuk është mirë me e mbajtur, qe po e lexoj, qato të thashë unë, mos të hyj me e përsërit. Nuk duhet me u mbajtur, ke thënë. Ndërsa, këta kanë thënë: unë e konfirmoj se do të ketë mbledhje në mes organizatorëve, për të organizuar festivalin në tjetër datë, ne u kërkojmë falje... – s’po hyjmë aty – edhe në fund thotë kemi këngëtarë nga Serbia, Kosova, boshnjakë kosovarë. Domethënë, a do të ketë, a do të ndërrohet data edhe çfarë këngëtarë, a do të pranoni muzikantë nga Serbia me pas?

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Pika eventuale është hequr nga unë. Arsyeja është që në seancën e fundit kanë mbetur veç katër asambleistë, edhe pyetjet që i keni bërë, nuk kanë prit me i marrë përgjigjet asambleistët. Kështu që, nuk e kam qit vetë, se me katër asambleista e kam mbajtur seancën gjysmë ore.

Artan Loshaj: Rrimë apo nuk rrimë, ajo është e jona. Po kërkojmë me pas aty, bon vaki në këtë seancë ka me pas të interesuar, se tash po duhet me hy në replika. “Unë e kam hek”! Ti duhet me e qit, s’kemi kuorum, e vazhdojmë, eventualja edhe me pesë veta mbahet. Nuk lypet në eventuale – unë sa e di – kuorum. Katër veta jemi, bëjmë pyetje, marrim përgjigje, s’ marrim përgjigje, atëherë shkojmë. Unë po kërkojmë që të jetë. Edhe është e palogjikshme mos me pas. Pse s’paska njerëz, tash po marrish vendim “unë jam”. Se edhe herën e parë qeshtu, për në Shajne, thaje unë me kryetarin e kemi vendosur. Diqysh po më vjen se si në mënyrë arbitrare po e bëni. Eventualja është pikë për hallet, për shqetësimet e qytetarëve. Dikush është këtu, dikush jo, ata s’ mund t’i obligosh me rrit, se nuk duhet kuorum. Unë po kam qef – bon vaki vetë kam me i bo dhjetë pyetje nesër – edhe tash s’un ma marrish të drejtën, pse s’por rri, për shembull, Edini, ose Muniri, hajde po shkojmë krejt. Për mu është e padrejtë edhe kërkoj

që nesër – kam me kërkue prapë, edhe sot po them – nesër pika eventuale të jetë si pikë e rendit të ditës.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Ti vetë e thaje që na rrimë apo s'rrimë, ti duhesh me e qit. E vërtetë është që e keni atë të drejtë me dalë. Po edhe unë e kam atë drejtë me e hek atë pikë. Qysh nuk e kam, po unë i bëj pikat. Edhe e kam pa të arsyeshme me e hek. Ti vetë ke qenë, kur ta ka ik ty krejt LDK-ja përjashta, mundesh me folë lirisht, a e ka lënë ndonjëherë? Ti mu ma ke bo një pyetje. Pse me dalë me t'u përgjigj, kur ti nuk je aty? Kur nuk po është kryetari, ju po thoni nuk është kryetari, po ikën, s'po iu përgjigjet pyetjeve. Ju vetë i keni bo pyetjet, vetë keni ikë, me katër asambleistë kam mbet deri në ora 17:00. Edhe unë kam familje, si krejt ju qysh keni familje, me i kqyrë punët. Edhe e drejta ime është me e hek pikën. Kështu që, e kam parë të arsyeshme këtë muaj me e hek, kur të vjen muaji tjetër e shoh që po rrini. Ti nuk je parashkollor, po edhe unë nuk jam mësuese, me ju nejt juve, rrini...rrini. Mundesh me e pyet Shabanin e Betimin, a e ka lëshue ndonjëherë krejt LDK-ja edhe ta kanë lënë ty me katër veta. Mundesh me hi me e kqyrë në Radio Sharr. Ke lyp shumë herë me e lëshue Radio Sharrin për pjesën e dytë, pse nuk e ke lyp fundin e seancës së kaluar? Mos kqyr veç për veti, por duhesh me kqyr edhe anash.

Artan Loshaj: Kur po bësh replikë me mu, po më vjen se shumë po nervozohesh. Po kam qef mos me u nervozue, se e hupish bukurinë, a po marrish vesh? Shumë mirë, qashtu, atëherë po të bëj hala ma shumë nervoz. Problemi tjetër është që – kupto një send – ti nuk je këtu gjyqtar. Këtu je veç për me e udhëheq seancën. Edhe nuk më qesish plus e minus mu, a jam, a s'jam.

Arijeta Skeraj: O Artan, po qysh more nuk të qes unë plus e minus? Po unë të qes, mos me qenë, unë ta qes minusin.

Artan Loshaj: Mos më ndërprej!

Arijeta Skeraj: Unë ta qes, kur s'je ta qes minusin, kur je ta qes plusin. Pse po folish kështu? Nuk jam gjyqtar, krejt e dinë që nuk jam gjyqtar, po unë jam kryesuese.

Artan Loshaj: A ka mundësi mos me m'ndërpre?

Arijeta Skeraj: Ti vetë e ke bo pyetjen, vetë po ikish. Po a e dish bre çka i ke bo kryetarit, kur s't'u ka përgjigj? Ti bile nuk duhet me folë për pikën eventuale, se ke ikë.

Artan Loshaj: Kur të foli unë, a ka mundësi mos me m'ndërpre?

Arijeta Skeraj: Vazhdo! Në qoftë se nuk vazhdosh, shkojsh në vend! Të lutem, vazhdo!

Artan Loshaj: Këto abuzimet nuk t'lejoj as ty, as kryetarit, po të kallxoj unë!

Arijeta Skeraj: Unë nuk po të bëj abuzim, po ta kallxoj të drejtën. Ti vetë mu ma ke bo pyetjen edhe ke ikë. Rrijshe! Unë gjyqtare po të dukem, kurrë nuk kam qenë gjyqtare.

Artan Loshaj: Unë po të them edhe një herë, nuk jam parashkollor këtu, mu qytetarët më kanë pru këtu. E drejtë e jemja është me folë unë çka të due edhe sa të due. Edhe a rri, a s'rri, është hera e fundit që ma përmendish mu, rri ose mos rri. Unë e kam kërkue pikën eventuale, edhe mos i ikni debateve,

mos i ikni sendeve. Është vit zgjedhor, po ju ikni debateve këtu si burrat, ti bëjmë pyetjet. Ti “unë jam!”, kush je ti mos me e qit eventualen? “Unë jam, e kam qit pikën e rendit të ditës”, po vijsh në Komitet po më thuesh unë jam ajo që e kam hek rendin e ditës. Bossi!

Arijeta Skeraj: Unë, sa për bossi, jam bossi! N’daç prano, n’daç mos e prano! Edhe e kam hek, edhe e kam vu. Fol tash, se mu nuk më pengosh, lirisht mundesh me folë. Nuk të ndali, nuk kam arsye edhe me të ndalë. Edhe vetë je gabim, ke bo pyetje, s’ke desht përgjigje. E ke akuzue shumë kryetarin – s’po iu del qytetarëve me iu dhënë përgjigje – ka mbet kryetari me katër asambleistë. Ti je i votuar, por edhe mu më kanë pru qytetarët këtu. Edhe kryetarin – bile kryetarin drejtpërdrejt e ka pru qytetari. Përveç qatyne minutave që i ke, të ndali, bile çuditësh! Qysh po duesh me u marrë vesh na? Edhe femër jam, po me ty bëhem burrë. Qysh të duash! A po duesh me u rrok me mu, se ja ke msy, shumë seanca je duke u marrë me mu. Unë këtu pyetem për pikat! Ti nuk ke me u pyet! E ke desht kërkesën, a të është pranue? Nuk të pranohet, veç për qeto sjelljet që i bojs nda një gruas, ndaj një motrës, ndaj një femrës. Shumë je i pasjellshëm! Këtë ta them në fytyrë, marre me të ardhë për Asamblenë! Tre mandate ke qenë këtu, a kam bë kështu ndonjëherë ndaj kryesuesit? Të jam bo pikë e zezë ty, po ke me m’durue!

Bexhet Xheladini: Unë po filloj me përgjigjet me rend. Po i përgjigjem Munirit. “Firma e cila i ka krye punimet e Ujësjiellit kryesor, ka lënë shumë material ndërtimor aty.” Kompania ende nuk i ka krye punimet. Ajo ka me vazhdue. Kështu që, kur ta përfundojë, asnjë material nuk do të mbetet aty edhe do ta kthejë në gjendjen e mëparshme kompania e cila është duke i kryer punimet. Sa i përket investimeve kapitale, ato të cilat Asambleja Komunale i ka miratuar në vitin 2024 për vitin 2025, nuk guxon kërkush me i ndërrue. Nuk ka të drejtë kërkush me i ndërrue. Kurse për propozimet e vitit 2026, të cilat do të miratohen në vitin 2025, atëherë Asambleja do të vendosë, edhe nëse ka aso tendenca që investimet kapitale në Rapçë do dikush me i ndryshue – e jo me i realizue ato që i ka miratue Asambleja – mundet me m’u drejtue mu si kryetar, edhe unë merrem me to. Sa i përket delegacionit, nesrit kompania ka shkue në Rapçë edhe, sipas menaxherit të projektit – tash unë fola në telefon – tha që ka qenë edhe i ka rregullue të gjitha ato, rrjetin e ndriçimit e ka rregullue të gjithë. Ndoshta ti ke qenë në Prizren, nuk ke qenë me e pa, por sipas menaxherit, ditën e nesërme, kompania ka shkue në Rapçë edhe i ka rregullue. Sa i përket Ujësjiellit, unë fola në telefon me menaxherin e projektit. Unë delegacionin e fshatit Rapçë e kam pranue në zyrë, e kam thirrë edhe mbikëqyrësin e Komunës, edhe janë marrë vesh që nesër kompania me shkue me i rregullue. Tash fola në telefon me mbikëqyrësin e Komunës, ai tha që kompania ka qenë ditën e nesërme në Rapçë edhe i ka rregullue. Unë po foli edhe një herë në telefon. Ju thatë se diku afër 20-25 llampa kanë qenë të djegura. Sa i përket Ujësjiellit – është fjala për ato pompat apo? – unë do të merrem personalisht me këtë problemin e pompave. E di që derisa ka qenë Sebahati gjallë u bo një problem, edhe ka mbet pa zgjidhë. Edin Kurti e bëri një pyetje për ndriçimin e Gora Mahallës. Edin, le të bëjë kërkesën përfaësuesi i mahallës, te drejtori i Emergjencave, edhe ne

menjëherë do të fillojmë pagesën e shpenzimit të ndriçimit të Mahallës së Epërme. Nëse diçka nuk është në rregull, ka ndonjë prishje, ne do ta çojmë mirëmbajtësin i cili e ka fitue tenderin, do t'i rregullojë edhe llambat të cilat janë të djegura. Sa i përket Artan Loshajt i cili i bëri dy pyetje, edhe për manifestimin, edhe për pikën eventuale. Sa i përket manifestimit, KKSJ-ja ka mbajtur nja takim dhe janë marrë disa qëndrime, konkluzione. Ne konkluzionet e KKSJ-së i kemi qit në faqe të Komunës. Në bazë të diskutimeve që janë bo, ky manifestim në këtë formë edhe në këtë datë nuk do të mbahet. Nëse do të vazhdojnë ata të insistojnë që ta mbajnë manifestimin në formën që e kemi parë në rrjete sociale, nuk do të mbahet. Por do të jemi në kontakt me kompaninë, kemi informata që ajo OJQ – AROG me duket – nuk është e regjistruar fare. Ta shohim, nëse del edhe kjo, atëherë ekziston edhe një arsye më tepër që ajo të mos bëhet. Edhe e dyta, ky po del që është një organizim privat, jo i organizuar nga Komuna, dhe është një organizim dhe manifestim profitabil. Manifestimet profitabile nuk paraqesin vlerat kulturore të komunitetit, por qëllimi është që ata me përfitue materialisht. Kështu që, ata mundën privat me organizue manifestime, por për ato duhet me marrë leje, edhe në Komunë, edhe në Polici. Ma merr mendja që edhe Policia nuk do t'ua jep atë leje në këtë formën qysh e kanë paraqit ata. Sa i përket pikës eventuale, Artan, ti e dish që pikat e rendit të ditës i cakton kryesuesja në bashkëpunim me kryetarin. Por, Asambleja ka të drejtë pastaj me vendos, me e fut ose me e hek. Mirëpo, kryesuesja ka të drejtë ekskluzive me i caktue pikat e rendit të ditës, me i cakue edhe asamblatë kur mbahen, edhe datat. Muajin e ardhshën, mundën me vendos kryesuesja që mos me e mbajtur asamblenë fare. E ka atë të drejtë, ti e dish këtë. Është konsultuar kryesuesja me mu, edhe unë kam qenë i pajtimit mos me e qit sepse ju po e lypni pikën e rendit të ditës, po i bëni pyetjet, por kur po vjen puna me ju përgjigj, ju po ikni. Këtu është problemi. Pyetjen kur të bojsh, duhet me nejt me e dëgjue, edhe me replikue nëse ka nevojë. Ne nuk jemi kundër pikës eventuale, por normal që duhet të ketë një disiplinë edhe duhet të ketë një rregull që, kur të parashtrijsh pyetjen, duhet me nejt me dëgjue edhe me e pa përgjigjen time. Sa u përket akuzave që po ia bësh, nuk është mirë. Unë nuk po due me e mbrojt kryesuesen, por i i bëjsh akuza të rënda që nuk qëndrojnë. Arijeta kurrë nuk ka qenë e shitur, ajo çdo herë i ka mbrojt interesat e votuesve të vet. Nuk po them interesat e partisë, por interesat e votuesve. Edhe gjithmonë ka qenë konsekuente, sa u përket qëndrimeve partiake, ajo asnjëherë nuk u ka ik qëndrimeve partiake dhe asnjëherë nuk ka qenë e shitur. Ne jemi të kënaqur si parti me kryesuesen edhe me asambleisten e katërfishtë, e cila çdo herë i ka mbrojt – përveç interesave të qytetarëve – edhe interesat e subjektit politik të cilin ajo e përfaqëson. Kështu që, ato mundën me qenë vetëm konstatime tuat, paragjykime tuat, a përndryshe, unë edhe si kryetar i partisë, jashtëzakonisht jam i kënaqur me punën e Arijetës si kryesuese dhe si asambleiste nga subjekti politik i LDK-së. Unë këtë e fola edhe në emër të kryetarit të partisë. Faleminderit!

Artan Loshaj: Ta mbylli një herë e përgjithmonë debatin me kryesuesen. Unë i kam fajet që e kam

votue – se ia kemi kthye borxhin, prapë po të them – të PDK’së – se delegatët e tu, kryetar, nuk e kanë votue për kryesuese. Unë i kam fajet që unë i pari ia kam dhënë votën dhe bashkë me Grupin Parlamentar ia kemi dhënë votën, po u krye mo, e kemi dhënë, nuk i biem pishman, por le ta dijë që me votën e PDK-së është kryesuese, se 4-5 asambleistët e juaj nuk e kanë votue. Kur është puna te eventualja, gojën plot transparencë e keni. Unë e bëj një pyetje – tash po më shtish me bo pyetje, se e kam lënë për nesër – eventualen me qëllim s’e keni bo. Në eventuale unë ta bëj pyetjen e qytetarëve, edhe ti dalish këtu i japish llogari asambleistit, nëse do me ngue. Përndryshe, përgjigjja – unë sa e di – e dëgjojnë qytetarët. Të ngon apo nuk të ngon Artani. Masnej kur po thuosh ti po bëni pyetje edhe po ikni, po thuosh kur ta jap unë përgjigjen me bo replikë. Sa herë më ke thënë që nuk po ia përmendi këtij asambleistit emrin, se po më replikon. Ti po biesh ndesh me vetveten. Sa herë më ke thënë ti, unë po ta jap përgjigjen, por mos bën replikë, s’po ta përmendi emrin se s’po due replikë. S’po di unë me ju. U mytët, transparenca-transparenca. Qite eventualen, s’ka, bëjmë pyetje, s’japish përgjigje, e mshelish, qaj që ka bo pyetje mos i jep përgjigje. Ka bo pyetje Artani, jem konë atë ditë kujdestar, ora u konë 15:30, s’une lo unë punën. Ke mund – s’qenka këtu Artani, mirë, po ia çojmë me shkrim, qysh keni lyp pyetje me shkrim, edhe ti përgjigje na çu me shkrim. S’qenka Artani këtu, herën tjetër. Edhe disa herë, për shembull, kur kam bo pyetje unë edhe kam shkue, ti ke kqyrë, s’qenka këtu, s’po i përgjigjem. Mos zini sebeb. Unë t’i lëshoj, o kryetar, bjere eventualen nesër, shtije në rend të ditës edhe unë po t’i bie krejta, sa herë ke thënë nuk po ia përmendi emrin se po lyp replikë, nuk qenkë këtu, herën tjetër. Mos, se katër vjet janë, s’janë katë seanca, 40 seanca ke qenë këtu. Transparencë-transparencë! Ku transparencë? Qit, mos u tutni, se vit zgjedhor, unë e di që e keni tutën.

Xhyllferie Bahtijari Beqiri: Përshëndetje për të gjithë! Sa i përket çështjes së votimit të kryesueses, desha të kyçem në këtë pjesën që po flitet në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, që nuk kanë të drejtë të tjerët. Sidomos në emër personal, gjithkush mundet me folë, në këtë rast nuk mujn me thënë kërkush që unë kam votue ose s’kam votue për vete, ndërsa për të tjerët s’kanë votue. Sa i përket kësaj çështjeje, unë me sa e kam kuptu, Grupi Parlamentar i PDK-së edhe personat e caktum që mendojnë që kanë pranue ofertën për me votue kryesuesen e propozuar nga LDK-ja, kanë përfitu në këtë rast vetëm nga kundërshtime të vogla të asambleistëve të LDK-së, e që faktikisht, kur ka ardhë votimi, të gjithë asambleistët e LDK-së – nuk po e përfshij veten time, unë e di si kam votu – por të tjerët mos i përfshini dhe mos folni në emër të atyre. I keni dëmtu në këtë rast, duke shpif në emër të tyre, kinse ju keni votue. Nuk është e vërtetë! Asnjëherë, Grupi Parlamentar i PDK-së nuk e mbështet një propozim të LDK-së më shumë sesa Grupi Parlamentar i LDK-së. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e kemi një

kërkesë nga OVL e UÇK-së, e cila e ka kërkuar një shumë 4 mijë euro. Siç e dini, ne çdo vit i kemi dhënë, por Komiteti në maksimum e ka deri në 2 mijë euro.

Artan Loshaj: Kur bëhet fjalë për Organizatën e Veteranëve, nuk diskutohet, unë jam pro. Unë jam qe 12 vite në Asamble, edhe po bëj çudi, unë e di që përpara Komuna ka bo këso organizime. Tash organizata me i marrë këto obligime, nuk e paskam ditë. Në qoftë se është e vërtetë, unë e jap maksimumin, do ta votoj. Manifestimet i bën Kuvendi Komunal i Dragashit, bashkë me kryetarin.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Ata e kanë bo kërkesën pak edhe për orendi të zyrës, edhe diçka kanë bo këtu kërkesë. Kush është pro kësaj kërkesë? Për shumën, 2 mijë euro. A ka kundër? Abstenim? Me 5 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë këtë kërkesë. Atëherë, e mbyllim këtë Komitet! Mirë u pafshim nesër në seancë!